Në kuptim të përgjithshëm me taktika mbrojtëse të të dyshuarit që gjijnë aplikim gjatë procesit të marrjes në pyetje nënkuftohet çdo veprim me anë të të cilët kryerësi i veprës penale tenton që të pamundësojë që pyetësi të vërtetojë fajësinë e tij, gjegjësisht, nëse kjo nuk do të jetë e mundur plotësisht, atëherë kjo fajësi të mbulohet dhe të ulet në masë sa më të vogël. Arsyesa themelore (motivi) pse i dyshuari gjatë procesit të marrjes në pyetje nuk vendos të thotë të vërtetën, dhe aplikon këto metoda mbrojtëse, është tentimi i tij që t'i shmanget pasojave që burojnë nga vepra penale. Kur themi pasoja nga vepra penale, nuk mendojmë vetëm për sanksionin eventual të një vepre të caktuar, por edhe për pasojet tjera që burojnë nga ky sanksion (për

shembull, dënimi me burgim mundet te i dyshuar të prodhojë frikën për humbjen e vendit të punës dhe me këtë rrezikimin e burimit financiar të familjes së tij, frika për humbjen e famës, humbjen e besimit te miqtë etj.). Si kanë lindur teknikat mbrojtëse të kryerësit të veprës penale, të cilat aplikohen gjatë procesit të marrjes në pyetje?

Fjalë kyçe: *taktikë, marrja në pyetje, i dyshuar.*

Hyrje

Njëri prej burimeve të konsiderueshme të këtyre taktikave, është përvoja personale apo e të tjera. Domethënë, kriminelët, veçanërisht ata me “stazh të gjatë” në karrierën e tyre profesionale kriminale nga marrja në pyetje e tyre, ndoshta disa herë nga ana e policisë. Gjatë atyre marrjesve në pyetje ata pa dyshim kanë arritur përvojë të caktuar, duke analizuar sjelljet e pyetësit dhe duke konstatuar gabimet e veta në dëgjimet e më hershme ato fitojnë një lloj përvoje në këtë drejtim. Në të njëjtën kohë ato shohin edhe përvojën e kolegëve të tyre nga sfera e kriminalitetit. Praktika ka treguar se vendi ku kriminelët fitojnë dije të reja është burgu. Qëndrimi në burg shpeshherë shndërrohet në “seminar të vogël për kriminalitet” përmes të cilit kryerësit e veprave të ndryshme penale gjejnë mundësinë, për të shkëmbyer midis tyre përvojat e fituara.

Sot, zhvillimi i shkencës dhe teknikës ka krijuar mundësinë, që kriminelët mënyrat se si duhet të sillen gjatë procesit të marrjes në pyetje mundet t’i gjejnë edhe në internet. Këto metoda janë të formulara në formë të librit, edhe atë:

- ▪ Pas burgosjes ata tentojnë nga ju të marrin deklaratë në veturën e policisë, në stacionin policor, apo kudo;
- ▪ Informata qe ke në kokën tënde nuk guxon në asnje mënyrë të lëshohet;
- ▪ Marrja në pyetje nuk është vetëm lojë pyetjesh dhe përgjigjesh, por situatë që përfundimi i të cilës është me pasoja;
- ▪ Polici në të njëjtën kohë ka dëshirën për sukses dhe frikën për lindjen e një konfrontim me ju, aspak ju nuk jeni të dobët;
- ▪ Polici aplikon taktika për të thyer rezistimin tuaj dhe një ndër ata është “ma mirë është për ty”; ▪ Polici në një moment do ta heq “veshjen

zyrtare” dhe do të tentojë të luajë rolin e avokatit. Mos i beso atij, kur ai diçka të këshillon, sepse këshillat mund t’i marrësh vetëm nga mbrojtësi yt. etj¹.

Teknikat mbrojtëse që i përdor i dyshuar gjatë procesit të marrjes në pyetje mundet të jenë të ndryshme. Në vazhdim do të prezantojmë vetëm disa nga ata që më së shumti gjejnë aplikim:

- Mohimi apo kundërshtimi;
- Heshtja apo mos dhënia e informacioneve lidhur me ngjarjen;
- Ndryshimi i deklaratës;
- Prezantimi i deklaratës paraprakisht të përgatitur².

Mohimi i veprës si taktkë mbrojtëse e të dyshuarit

Mohimi është lloj i veprimeve mbrojtëse të të dyshuarit, me të cilën ai pjesërisht apo plotësisht mohon ekzistimin e fakteve të cilat e akuzojnë. Ekzistojnë lloje të ndryshme të mohimit:

Varësisht nga ajo se provat e akuzës mohohen plotësisht apo vetëm në segmente të veçanta dallojmë:

- mohim të plotë,
- pohim të pjesshëm³.

Varësisht nga mënyra se si aplikohet dallojmë:

- mohim të sigurt dhe konsekuent,
- mohim jo të sigurt dhe jo konsekuent⁴.

¹ Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 234.

² Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 235.

³ Shih: Siminovic, B.; Pribavljanje i ocean iskaza pred policijom i na sudom, Praven fakultet u Kragujevac, Kragujevac, 2007, fq. 225.

⁴ Shih: Po aty.

3. Përveç kësaj, mohimi mundet të jetë dhe:

- a) mohim i argumentuar, dhe
- b) mohim jo i argumentuar (i dyshuari mohon provat e akuzës kurse më pas nuk ofron asnjë fakt ose provë, me të cilat do të vërtetojë mohim e tij)⁵.

Literatura jonë procedural penale, por edhe ajo e huaj, deklarimit të të dyshuarit i kushton vëmendje vetëm kur ajo paraqitet në formë të pranimit. Nëse kihet parasysh se edhe pranimi edhe mohimi i argumentuar kanë vlerë provuese të njëjtë, praktika që t'i jepet rëndësi vetëm pranim, llogaritet si e gabuar. Mohimi mundet të jetë teknikë mbrojtëse shumë efikase e të dyshuarit. Domethënë, i dyshuari, duke u nisur nga supozimi se vetëm ai ka dijeni lidhur me ngjarjen kriminale, vendos ta aplikojë këtë metodë. Gjithashtu, ai nuk është i obliguar me barrën e provave.

Nëse nuk do të disponohet me material provues adekuat, mohimi do të jetë një pengesë e pakalueshme në rrugën e gjetjes dhe vërtetimit të së vërtetës lidhur me një vepër penale të caktuar. Nuk duhet të hamendemi dhe të besojmë se mohimi i fajësisë gjithmonë paraqet takтикë mbrojtëse e të dyshuarit dhe si e tillë është e rrejshme. Mohimi ndonjëherë mundet të jetë edhe si karakteristikë e të dyshuarit të pafajshëm dhe si e tillë të jetë e drejtë dhe e sinqertë. Burim i rëndësishëm i informacionit lidhur me atë se mohimi, a është i vërtetë apo i rremë, është fotografia simptomatike e të dyshuarit⁶. Megjithatë, në numrin më të madh të rasteve vetëm ajo nuk do të jetë e mjaftueshme, për të na ofruar përgjigje në pyetjen se i dyshuari që mohon a flet të vërtetën. Dhe mu për këtë, indicjet që na ofrohen nga fotografia simptomatike duhet gjithmonë të përcillen edhe me informacionet dhe materialet tjera provuese.

Kur flitet për vlerësimin e besueshmërisë së mohimit, veçanërisht e rëndësishme është se a është mohimi jo i argumentuar⁷(i dyshuari mohon akuzën dhe më pas nuk afron fakte dhe prova për të vërtetuar mohimin e vet), apo i dyshuari prezanton fakte dhe prova me anë të të cilave vërteton mohimin e tij. Për shkak se mohimi i paargumentuar është konstatim i thjeshtë, i cili nuk është i mbështetur në asnjë fakt apo provë, dhe si i tillë nuk llogaritet

⁵ Shih: Schwindt, F.; Policisko presllushanje, Prirucnik, MUP RH, 15/2003, fq. 47.

⁶ Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 239.

⁷ Shih: Schwindt, F.; Policisko presllushanje, Prirucnik, MUP RH, 15/2003, fq. 47.

si provë në procedurë penale, njëjtë ashtu, që si provë në procedurë penale nuk do të llogaritet as pohimi i akuzuesit, nëse akuza e tij nuk mbështet në fakte dhe prova të mjaftueshme. Mungesa e fakteve dhe provave, me të cilat do të vërtetohet përmbajtja e mohimit, me të drejtë na çon në supozimin se ato nuk ekzistojnë, dhe kështu këto lloje të mohimit në esencë llogariten si indicje lidhur me fajësinë e të dyshuarit. Për këtë shkak i dyshuarit duhet në mënyrë të quartë të paraqes fakte dhe prova lidhur me mohimin, nëse është i pafajshëm, sepse me veprime jo të argumentuara mundet vetes së tij t'i sjellë dëm të madh. Duhet gjithashtu të potencohet se nëse dikush si i dyshuar nuk do të prezantojë argumente që shkojnë në interes të mbrojtjes së tij (mohim jo i argumentuar), kjo detyrimisht nuk do të thotë se ai është fajtor. Mund të kemi raste kur edhe i dyshuar i pafajshëm jo inteligjent, apo nga ndonjë arsyе e tij personale, nuk do të sjellë argumente lidhur me mbrojtjen e tij, nëse dëshiron të fshehë ndonjë sekret të tij, do të mbrohet në këtë mënyrë.

Për dallim nga mohimi jo i argumentuar, mohimi i argumentuar posedon vlerë të madhe, për shkak se i dyshuarit do të prezantojë fakte me të cilat do të mohojë akuzën.

Kjo do të jetë e mundur në situatat vijuese:

1. Prezantimi i të vërtetës në mënyrë të argumentuar– mënyra më e mirë për të vërtetuar të vërtetën është, kur i dyshuarit do të mohojë fajësinë duke argumentuar të vërtetën. Kjo sjellje është karakteristikë e të dyshuarve të pafajshëm.

2. Prezantimi i të pavërtetës në mënyrë të argumentuar– mbrojtja e të dyshuarit duke prezantuar të pavërteta është një mënyrë legjitime që e përdorin ato. Megjithatë, nëse i dyshuarit do të zbulohet se mashton, mashtimi i tij do të forconte fuqinë provuese të indicjes lidhur me fajësinë e tij, e cila veç më ekziston.

3. Ekzistimi i disa fakteve në mënyrë mashtruese do të mohohet, ndërsa disa do të prezantohen në mënyrë të vërtetë – për vërtetimin e të vërtetës gjithsesi se situata do të jetë shumë e rrezikshme, kur i dyshuarit pranon si të vërteta ekzistimin e disa fakteve, ndërsa ekzistimin e disave e mohon në mënyrë të rrejshme. Domethënë, shpeshherë ndodh që gjithë deklarata të

humbasë vlerën e saj vetëm për shkak të asaj se është argumentuar se një pjesë e saj është e pavërtetë⁸.

Heshtja si takтикë mbrojtëse e të dyshuarit

Shikuar në aspekt gjeneral, gjatë procesit të marrjes në pyetje të mundura janë dy strategji mbrojtjeje të të dyshuarit:

- deklarimi i të dyshuarit gjatë procesit të marrjes në pyetje, pa marrë parasysh se ai do të jetë i vërtetë, pjesërisht apo plotësisht i rrejshëm, dhe
- heshtja e të dyshuarit⁹.

E drejta për heshtje është e drejtë e garantuar me ligj, ku i dyshuari nuk është i obliguar të prezantojë mbrojtjen e vet, si dhe as të përgjigjet në pyetjet e parashtruara.

Para çdo marrjeje në pyetje, i pandehuri informohet për: e drejta për ë heshtur dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç se të japë informacion në lidhje me identitetin e tij / të saj (nen 153 paragrafi 3.3)¹⁰.

Mundemi të dallojmë këto lloje të heshtjes:

- heshtje e plotë,
- heshtje deri në përfundim të procedurës provuese,
- heshtje duke mos deklaruar për gjendjen faktike personale, me qëllim që më vonë provat e akuzës të vihen në pikëpyetje¹¹.

Heshtja në praktikë si takтикë mbrojtëse e të dyshuarit manifestohet ashtu që i dyshuari, pas parashtrimit të pyetjes së parë, e drejton pyetësin që përgjigjen e tij ta kërkojë nga mbrojtësi i tij, si dhe në çdo pyetje tjetër të parashtruar do të përgjigjet me heshtje të plotë. Heshtja e kombinuar me mohim paraqet takтикë mbrojtëse shumë efikase.

Domethënë, i dyshuari mohon citatet e padisë, dhe njëkohësisht shmanget nga analizimi logjik i tyre. Për këtë shkak heshtja e kombinuar me

⁸ Shih: Siminovic, B.; Pribavljanje i ocean iskaza pred policijom i na sudom, Praven fakultet u Kragujevac, Kragujevac, 2007, fq. 229.

⁹ Shih: Vodinic, V. Dokazana vrednost poricanja y kricicnom postupy, JRKK, 1997, fq. 77.

¹⁰ Shih: Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale.

¹¹ Shih: Po aty.

mohim është situatë e vështirë, për të nxjerrë informacione lidhur me veprën penale. Për përparësitë e heshtjes të kombinuar me mohim na shpjegon autor i A. Babrs kur thotë: “nëse i dyshuari do të lëshohet në komunikim atëherë do të japë përgjigje në pyetjet e parashtruara, do të ofrojë faktet dhe të kundërshtojë me argumente padinë, por nëse i dyshuari do të jetë jo i sinqertë, pashmangshmërisht do të futet në kundërthënie, të cilat nuk do të ketë mundësi t’i sqarojë¹².

Vlera provuese e heshtjes shpeshherë ka qenë objekt diskutimi i autorëve të ndryshëm. Ajo që është e pakontestueshme është se heshtja nuk është, as nuk mundet të jetë provë fajësie. Të gjitha përgjigjet e kësaj pyetje mundet të ndahanë në tre grupe:

- Heshtja nuk mundet të llogaritet si indicje përfajësinë¹³, për shkak se heshtja mundet të jetë karakteristikë edhe e të dyshuarit të pafajshëm. Arsyet që i dyshuari i pafajshëm të mbrohet me heshtje minden të jenë të ndryshme: çrrëgullimet e ndryshme shpirtërore, përjetimi i shokut emocional etj. Edhe pse këto raste në praktikë janë të rralla, prapëseprapë mundet të ndodhin.
- Heshtja mundet të llogaritet si indicje përfajësinë nga shkaku se i dyshuari nga frika përfi të mos u ngatërruar në mashtrimin e vet, mundet të zgjedhë të mbrohet me heshtje¹⁴.

Praktika na tregon se në rastet kur i dyshuari kupton se policia nuk disponon me prova të mjaftueshme përfi të mbështetur fajësinë e tij, ai do të vendos që të mbrohet me heshtje. Megjithatë, përcaktimi i të dyshuarit që mbrojtjen e tij që në fillim ta mbështessë në heshtje në praktikë nuk është shumë e shpeshtë, sepse edhe kryerësi i vërtetë në të shumtën e rasteve sillet në mënyrë të ngjashme si i dyshuari i pafajshëm, analizon faktet akuzuese ndaj tij dhe tenton që t’i mohojë.

- Heshtja si e tillë nuk mundet të vlerësohet as si indicje e fajësisë, as si indicje e pafajësisë¹⁵. Përgjigja më e pranuar lidhur me heshtjes është ajo se nuk është i pranueshëm qëndrimi se heshtja nuk flet asgjë lidhur me fajësinë e të dyshuarit. Heshtja fletë, mirëpo domethënja e saj është me shumë kuptime,

¹² Shih: Babrs, A.: Die Vulgarluge in der gerichtlichen Praxis, Germany, 2003, fq 212.

¹³ Shih: Rogall, K.: Der Beschuldigte gegen sich selbst, Doicland, 2005, fq.157.

¹⁴ Shih: Po aty.

¹⁵ Shih: Po aty.

për shkak se mund të mbrohet me heshtje edhe i dyshuar i pafajshëm edhe kryerësi i vërtetë.

Për dallim nga heshtja e plotë, heshtja e pjesshme mund të trajtohet si indicje lidhur me fajësinë për arsyen se i dyshuar në pyetjet që i konvenojnë jep përgjigje, kurse në ato që nuk i konvenojnë hesht. Në fund duhet të theksojmë se heshtja e të dyshuarit, edhe pse është një mënyrë legale dhe legitime për mbrojtjen e tij, dëmton procesin e vërtetimit të të vërtetës. Domethënë, i dyshuar (nën supozimin se është kryerës i vërtetë) më mirë se çdo kush tjetër di se si ka ndodhu një ngjarje e caktuar.

Përcaktimi i tij për t'u mbrojtur me heshtje do të llogaritet si humbje e një burimi të rëndësishëm të informacionit. Për këtë shkak pjesëtarët e policisë që realizojnë procesin e marrjes në pyetje duhet të tentojnë që të dyshuarin ta tërheqin në bisedim, por në asnjë mënyrë duke aplikuar metoda që do të na çonin në deklarim të detyrueshëm.

Simulimi (shtirja) disimilimi (fshehja) dhe agravimi (përkeqësimi) si taktika mbrojtëse e të dyshuarit

Simulimi definohet si tentim i vetëdijshëm i personave të shëndoshë dhe normal, që gjendjen e tyre ta paraqesin tjetër fare nga ajo që është realisht. Domethënë, duke aplikuar simulimin si njëren nga teknikat mbrojtëse gjatë procesit të dëgjimit, i dyshuar me qëllim dhe vetëdije shtiret si sëmurë fizikisht, apo si i sëmurë shpirtërisht¹⁶. Shpeshherë kur i dyshuar ndodhet në situatë të zbulimit të mbrojtjes së rrejshme, simulimi përdoret si metodë nga i dyshuar, me qëllim që të fitojë në kohë, për të konsoliduar mbrojtjen e vet. Shpeshherë simulohen këto gjendje dhe sëmundje: humbja e vetëdijes, shurdhmemecja, amnezia, epilepsia etj. Simulimi mundet të jetë i përgatitur dhe planifikuar me kujdes, por mundet të jetë edhe vendim i çastit.

Disimilimi është fshehje me vetëdije e simptomave të sëmundje organike, apo të çrregullimeve shpirtërore¹⁷.

¹⁶ Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 241.

¹⁷ Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 241.

Agravimi paraqet zmadhim me vetëdije apo pavetëdije të gjendjes së vet minimalisht të çrregulluar fizike apo mentale¹⁸. Në numrin më të madh të rasteve punonjësi operativ me përvojë këto sjellje mundet lehtësisht t'i kuptojë.

Ndryshimi i deklaratës si taktikë mbrojtëse e të dyshuarit

Deri te ndryshimi i deklaratës më së shumti vjen gjatë kohës, kur provat e reja nuk do të kenë mundësi apo me shumë vështirësi në mënyrë të sigurt të verifikohen. Ndryshimi i deklaratës do të jetë aktuale në të gjitha fazat e zbulimit, zbardhjes dhe argumentimit të veprës penale, që nga procedura parapenale dhe deri te seanca kryesore. I dyshuarit deklarimin e vet gjithmonë do të përpinqet ta përshtatë me situatat e reja, duke u munduar që të ballafaqohet me provat e reja, por në të njëjtën kohë duke mos u larguar nga versioni i tij mbrojtës i rrejshëm¹⁹.

Në raste kur provat do të shkojnë në favor të interesit të tij, do të tentojë që deklaratën e tij ta përshtat me këtë situatë, duke u munduar që diçka të deklaruar me herët ta ndryshojë. Kjo situatë në mënyrë më të mirë do të shfrytëzohet nga të dyshuarit me përvojë dhe inteligjent. Shkaqet për shkak të të cilëve i dyshuarit do të vendos të ndryshojë deklaratën mundet të jenë të ndryshëm. Disa nga ato mundet të jenë të sinqerta, dhe disa jo²⁰.

Për shembull, është e mundur që deklarimi i parë të jetë dhënë në gjendje shoku menjëherë pas kryerjes së veprës penale, dhe më pas kur ai mendon se disa të dhëna të veçanta nuk shkojnë në interes të mbrojtjes së atij, ai vendos t'i tërheqë duke i ndryshuar ato. Gjithashtu, mund të ndodhin raste kur policia në mënyrë brutale ka vepruar dhe ka marrë deklaratën nga i dyshuarit, dhe pas fillimit të procedurës penale, i dyshuarit në të shumtën e rasteve nga këshillat e mbrojtësit të vetë, bënë ndryshimin e deklaratës së tij, me arsyetimi se kjo deklaratë është dhënë nën presion.

Ndryshimi i deklaratës të të dyshuarit gjatë procesit të marrjes në pyetje mundet të variojë nga ndryshimi i plotë (ashtu që deklarata e re do të jetë kontradiktore me atë të dhënë paraprakisht), deri te ndryshimi i pjesshëm,

¹⁸ Shih: Po aty.

¹⁹ Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 173.

²⁰ Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 243.

kështu që deklarata e re paraqet plotësim, precizim, gjegjësisht mohimi i pjesëve te caktuara të deklaratës të dhënë më herët.

Që ndryshimi i deklaratës të jetë i pranueshëm dhe i besueshëm, ajo duhet të përcillet me dhënien e arsyes së përshtatshme e cili do ta justifikojë këtë ndryshim. Më së shumti në praktikë përdoren këto pretekste: "Nuk më kujtohet të kem thënë një gjë të atillë...", "Gabimisht më keni kuptuar kur kam thënë...", "Ka mundësi që atë t'ua kem thënë juve. Megjithatë, atë ditë shikueshmëria ka qenë e dobët..." etj. Kur flitet lidhur me ndryshimin e deklaratës, duhet të theksohet se deri te ndryshimi vjen gjatë procesit të hetimit dhe sa më shumë që të zgjasë hetimi, aq me e madhe do të jetë tendenca për ndryshim të saj, me qëllim të minimizimit të fajësisë së të dyshuarit²¹.

Ndryshimet e shpeshta dhe të paargumentuara të deklaratës paraqesin indicje të fuqishme lidhur me fajësinë e të dyshuarit. Kjo është një taktkë e mirë që e përdorin kryerësit e veprave penale gjatë procesit të marrjes në pyetje. Kjo taktkë e të dyshuarit duhet të pritet nga ana e punonjësit operativ i përgatitur. Që mundësinë e ndryshimit të deklaratës ta zbresim në një nivel sa më të vogël, në rastet kur për këtë ka edhe kushtet, deklarata duhet të incizohet me anë të teknikës audio-vizuale.

Prezantimi i deklaratës paraprakisht të përgatitur (mbrojtje e paramenduar e të dyshuarit)

Në rastet kur nuk do të jetë e mundur t'i iket përgjegjësisë penale lidhur me veprën e kryer penale, kryerësi i veprës penale do të orvatet që këtë përgjegjësi ta ulë në masë mundësisht sa më të vogël. Domethënë, duke llogaritur paraprakisht se një ditë, për shkak të veprimit tarisë së vet kriminale mundet të dënohet nga ana e shtetit, kryerësit e veprave penale qysh përpara parapërgatitin deklaratën që do të prezantonin, nëse do të ndodhë eventualisht dëgjim nga policia ndaj tyre, si dhe provat që do ta mbështesin këtë deklaratë. Në praktikë ndodhin shpesh situata që shitësit e lëndëve narkotike të mbajnë gjithmonë sasi të vogël të drogës anash, ashtu që në rast se do të zbulohen, të kenë mundësi që vëmendjen e policisë ta orientojnë në ato vende me sasi të vogël, kështu që pjesa kryesore e drogës gjithë kohën të jetë e sigurt. Të

²¹ Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 173-174.

shtypur nga provat gjatë procesit të marrjes në pyetje, i dyshuar mundet të vijë në situatë që ta lë versionin e tij të rrejshëm dhe të pranojë fajësinë²².

Megjithatë, në vend që të deklarojë të vërtetën plotësisht, ato deklarojnë vetëm një pjesë të vogël të saj. Në këtë kuptim, ata do të “zbulojnë” vendin se ku e kanë fshehur “mallin”, por në atë vend policia do të gjejë vetëm një pjesë të vogël të tij²³. Gjersa policia do të jetë e kënaqur, duke menduar se rasti plotësisht është zgjidhur, në këto raste edhe kryerësi i veprës penale do të jetë i kënaqur se sasia kryesore e “mallit” do të ruhet dhe do të mbetet e pazbuluar. Në të njëjtën kohë ata do të mbajnë përgjegjësi më të vogël penale sesa t’u zbulohet e gjithë sasia e tij (për shembull. përgjegjësia nuk është e njëjtë, nëse në pyetje do të jetë 1 kilogram apo 10 gram). Edhe pse kjo takikë është karakteristikë e shitësve të drogës, ajo me sukses mundet të aplikohet edhe në veprat tjera penale.

Kështu, kryerësi i veprave penale të vrasjeve, vjedhje dhe të ngjashme mundet të vendosi në një anë një pistoletë, e cila nuk ka qenë e përdorur për vrasjen. Gjithashtu, në harmoni me këto teknika mbrojtëse shpeshherë kryerësit paraprakisht përgatisin edhe albinë, kështu që kryerësit e veprave penale që më parë merren vesh për deklaratën me “dëshmitarët” potencial, si dhe përgatisin prova që këtë alibi ta vërtetojnë²⁴.

Nga kjo që u tha, mundemi të konstatojmë se në pamundësi për t’i ikur përgjegjësisë penale, kryerësit e veprave penale përpiken që sa më shumë të jetë e mundur t’i orientojnë hetimet në drejtim ku atyre më së shumti u konvenon. Deklarata paraprakisht e përgatitur dhe provat që e mbështesin atë, si qëllim kanë që organin për zbulim ta bindin se është në rrugë të drejtë. Punonjësi operativ me përvojë të pamjaftueshme lehtësisht do të tërhiqet në atë version, dhe me këtë do të devijojë nga rruga, e cila çon në vërtetimin e plotë të së vërtetës lidhur me një vepër të caktuar penale.

²² Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 176.

²³ Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 176.

²⁴ Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 245.

Teknikat tjera mbrojtëse të të dyshuarve

Taktikat mbrojtëse që i përdorin të dyshuarit janë në numër më të madh. Përveç atyre që u potencuan, në shprehje mund të vinë edhe këto:

Të menduarit mirë që i paraprin përgjigjes në pyetjen e parashtruar²⁵ – për dallim nga i dyshuari i pafajshëm, i cili nuk ka çka të fshehë dhe në pyetjet e parashtruara nuk ka nevojë të mendohet si të përgjigjet, te kryerësit e vërtetë kjo nuk ndodh. Ata para së të përgjigjen në pyetjen e punonjësit operativ, bëjnë një pauzë të shkurtër për t'u menduar se çfarë përgjigjeje të jasin. Ndonjëherë, pauza që i paraprin përgjigjes së pyetjes të punonjësit operativ, mundet të jetë karakteristikë edhe e të dyshuarve të pafajshëm. Kjo, para se gjithash do të ndodhë si rast, nëse situata për të cilin ka të bëjë pyetja ka ndodhur në të kaluarën, dhe për këtë i dyshuari ka nevojë për kohë për t'u kujtuar lidhur me disa detaje, që janë në lidhshmëri me ngjarjen. Gjithashtu, ndonjëherë ndërlikueshmëria e pyetjes së parashtruar ka nevojë që i dyshuari pak të mendohet para se të përgjigjet dhe, kjo mund të jetë si pasojë e aftësive intelektuale të ulëta, stresi që është prezent tek ai dhe të ngjashme. Ashtu si të menduarit e të dyshuarit përpara se të përgjigjet në pyetjet e punonjësit operativ mundet të jetë si indicje për fajësinë e tij, gjithashtu njëjtë me këtë edhe përgjigjet e shpejta e të dyshuarit, të cilat kanë nevojë pak për t'u menduar, gjithashtu mundet të paraqesin indicje për fajësinë e tij²⁶. Domethënë, nëse në ndonjë pyetje të ndërlikuar, e cila vërtetë kërkon pak kohë nga i dyshuari për t'u menduar para se të përgjigjet (për shembull, të kujtohet lidhur me disa detaje lidhur me ngjarjen), nëse i dyshuari përgjigjet menjëherë, kjo mundet të na tregojë se përgjigja e tij ka qenë që më herët e parapërgatitur dhe si e tillë paraqet indicje për fajësinë e tij. Në fund mundemi të themi se ashtu si që është përgjigja e të dyshuarit në ndonjë pyetje të ndërlikuar, dhe për të cilën paraprakisht nuk ka nevojë të mendohet, indicje për fajësinë e tij, njëjtë indicje për fajësinë e tij është edhe nevoja e të dyshuarit për t'u menduar, para se të përgjigjet në ndonjë pyetje të thjeshtë.

²⁵ Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 176-177.

²⁶ Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 248.

Përsëritja e pyetjes së parashtruar²⁷ – mënyrë shumë e shpeshtë që e përdor i dyshuari për të fituar në kohë dhe për t'u menduar lidhur me përgjigjen është edhe përsëritja e pyetjes së parashtruar. Për shembull: Punonjësi operativ: “A ke qenë edhe ti prezent atëherë kur ndodhi kjo gjë...?” I dyshuari: (në mënyrë të ngadalësuar përsërit pyetjen) “A kam qenë unë prezent atëherë kur ndodhi kjo gjë...?” (dhe pas kësaj pason një pauzë e shkurtër dhe përgjigja), “Jo, u thash se nuk kam qenë”.

3. Deklarime dhe sqarime të pakëruara dhe shumë të hershme lidhur me ngjarjen²⁸ – shpeshherë kryerësi i vërtetë do të dëshirojë që të deklarojë versionin e vet, përpara se punonjësi operativ një gjë të këtillë të ketë kërkuar nga ai. Ata janë të padurueshëm për të dhënë sqarimet e tyre, duke theksuar ato që shkojnë në interes të pafajësisë së tij. Nëse punonjësi operativ do ta pyesë atë: “A e ke kryer ti këtë...?”. Ai në këtë pyetje do të përgjigjet me mohim të veprës dhe menjëherë pas kësaj do të japë sqarime që shkojnë në interes të pafajësisë së tij. Për dallim nga kryerësi i vërtetë, i dyshuari i pafajshëm do të thotë: “Jo, unë atë nuk e kamë kryer”, dhe më pas nuk do të jap sqarime, por do të presë pyetjen pasuese të punonjësit operativ.

4. Orientimi në ato burime të cilat janë të pamundura të verifikohen²⁹ – i dyshuari i pafajshëm, nëse e orienton punonjësin operativ do ta orientojë në ato burime që kanë mundësi për t'u verifikuar. Kurse, kryerësi i vërtetë për të mbrojtur versionin e vet të rrejshëm, shpeshherë do të thirret në ato burime të cilat punonjësi operativ nuk do të ketë mundësi t'i verifikojë. Për shembull: “Të ishte babai im gjallë, ai juve me siguri këtë që u them do t'ua vërtetonte...” apo “Për këtë që u them mundet të pyetni shefin tim (shokun, vëllanë...), ai juve do t'u thoshte...” Punonjësi operativ deri te këto burime ose nuk ka mundësi që të vijë, ose nëse do të vij deri te ato, nga ato nuk do të fitonte të dhëna që fajësojnë të dyshuarin.

5. Tentimi për të diskredituar punonjësin operativ, viktimin, dëshmitarin³⁰ – shumë shpesh kryerësi i vërtetë do të përpinqet që të diskreditojë punonjësin operativ, të dëmtuarin, dëshmitarët. Duke i diskredituar ata, ai në të njëjtën kohë diskrediton edhe akuzën e tyre. Për

²⁷ Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 176-177.

²⁸ Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 176-177.

²⁹ Shih: Po aty.

³⁰ Shih: Po aty.

shembull, kur objekt i diskreditimit është punonjësi operativ, i dyshuar mundet të deklarojë për tentim të sajimit të provave lidhur me fajësinë e tij nga ana e punonjësit operativ. Ai deklaron se gjatë kohës së privimit të lirisë janë shkelur të drejtat e tij. Gjithashtu, ai do të tentojë të diskreditojë edhe viktimin, duke u munduar ta paraqesë si person gënjeshtar, se kjo për të nuk është hera e parë, që akuzon në mënyrë të rrejshme dikë.

6. Mirësjellje e tepruar, respektim dhe dëshirë që të “ndihmohet” punonjësi operativ³¹ – si indicje e shpeshtë e fajësisë së të dyshuarit mundet të jetë edhe mirësjellja e tepruar ndaj punonjësit operativ, respektimi ndaj tij dhe dëshira që t’i “ndihmohet” atij për të zbardhur rastin. Më këtë mënyrë, i dyshuar tenton që punonjësi operativ të fitojë mendim pozitiv, gjegjësisht, te ai të formojë bindjen se i dyshuar nuk është person i cili do të kryente vepër penale. Nëse i dyshuar në këtë do të ketë sukses, mundësia do të jetë e madhe që punonjësi operativ të bindet në pafajësinë e tij.

7. “Nënvizimi” i sinqeritetit të tij³² – njëra nga mënyrat që kryerësi i vërtetë shpeshherë e përdor për të “bindur” punonjësin operativ në sinqeritetin e tij. Fraza që më së shumti përdoret në këtë drejtim “Beto hem se unë...”, “Në çka doni të beto hem që të më besoni ?”, “Mos dalsh i gjallë nga këtu nëse ju mashtro...”, si dhe shumë të tjera të ngashme me këto.

Perfundimi

Nga kjo që u prezantua më lartë, mundemi të konstatojmë se mohimi i fajësisë është njëra nga takikat mbrojtëse më të shpeshta të kryerësve të veprave penale. Megjithatë, në të njëjtën kohë ajo mundet të jetë si mënyra e vetme e mbrojtjes së personave të pafajshëm. Për këtë shkak, pjesëtarët e policisë detyrimisht duhet të jenë shumë të kujdeshëm, kur gjatë veprimeve të tyre do të kenë përparrë një të dyshuar që mohon fajësinë. Kjo është edhe obligim ligor për pjestarët e policisë: Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm (neni 7 paragrafi 1)³³.

³¹ Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 178-179.

³²

³³ Shih: Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale.

Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit (nen 1)³⁴.

Mohimi, padyshim posedon një vlerë të madhe orientuese. Dhe sa i takon vlerës së tij provuese, ai ka të njëjtën vlerë provuese si pranimi, por vetëm atëherë kur ajo do të verifikohet me të gjitha provat e grumbulluara, si ato materiale, ashtu edhe ato personale.

Literatura

1. Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996.
2. Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002,e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992.
3. Rogall, K.: Der Beschuldigte gegen sich selbst, Doicland, 2005.
4. Siminovic, B.; Pribavljanje i ocean iskaza pred policijom i na sudom, Praven fakultet u Kragujevac, Kragujevac, 2007.
5. Vodinelic, V. Dokazana vrednost poricanja y kricicnom postupy, JRKK, 1997.
6. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale.
7. Babrs, A.: Die Vulgarluge in der gerichtlichen Praxis, Germany, 2003.
8. Schwindt, F.; Policisko presllushanje, Prirucnik, MUP RH, 15/2003.
9. Babrs, A.: Die Vulgarluge in der gerichtlichen Praxis, Germany, 2003.

³⁴ Shih: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrëtare, Tetor. 2010.

FIGURAT E REJA TË DËMIT MODERN. KALIMI NGA KONCEPTI I PËRGJEGJËSISË CIVILE NË ATË TË DREJTËSISË SË DËMEVE

PhD Cand. Elena FILIP

Fakulteti i Drejtësë, Universiteti i Tiranës elena.filip@fdut.edu.al

Prof. Asoc.Dr. Anjeza LIÇENJI

Fakulteti i Drejtësë, Universiteti i Tiranës anjeza.licenji@fdut.edu.al

Abstrakt

Civil liability is the legal responsibility that requires the responsible party to compensate for the harm caused to third parties. To establish civil liability, both in contractual and non- contractual obligations, the existence of damage must be proven. In a society where scientific and technological development and progress are part of everyday life, an urgent need arises to prevent and compensate for all modern forms of damage. Today, legal trends are shifting, placing compensation and restitution of damages at the forefront. This shift has led to the abandonment of the adage that there is no civil liability without fault, and the acceptance of the new concept that, in fact, there is no civil liability without a tort. At a time when the concept of tort law has been strengthened, many new forms of torts have emerged, such as torts for defective products, nuclear torts, IT torts, genetic torts, aesthetic torts, environmental damage, and various types of personal torts.

Keywords: *civil liability, tort law, new torts, damage compensation, modern damages.*

HYRJE

Përgjegjësia civile njihet si një institut që përbëhet nga tërësia e rregullave që detyrojnë përgjegjësin e dëmit të dëmshpérblejë dëmet që u ka shkaktuar të tretëve¹. Ky përkufizim është në fakt shumë i ngjashëm me atë të autorit francez Doyer René Savatier që e përkufizon përgjegjësinë civile si: “detyrimi që bie mbi një person për të riparuar dëmin e shkaktuar një tjetri nga veprimi/mosveprimi i tij ose nga veprimi i një personi tjetër a sendeve të varura prej tij”²². Pra, përgjegjësia civile lind në rastin e mospërbushjes së detyrimit të debitorit në detyrimet që lindin nga kontrata ose lind në momentin e shkaktimit të dëmit në rastet e një detyrimi jashtëkontraktor.³

Sikurse në detyrimet kontrakte, ashtu dhe në ato jashtëkontraktore që të flitet për përgjegjësi civile kërkohet si kusht kryesor ekzistencia e dëmit. Në kuptimin juridik, me fjalën dëm kuptojmë humbjen e të mirave juridikisht të mbrojtura⁴. Dëmi mund të jetë një lëndim, dëmtim apo përkeqësim, material ose moral që një person përjeton në jetën, integritetin fizik, shëndetin, asetet, pasurinë dhe të drejtat e tij⁵. Në të vërtetë, ai është një shkelje e të drejtave subjektive ose e interesave të një subjekti të shkaktuara me veprim të dëmshëm,⁶ që mund të paraqitet në formën e dëmit kontraktor⁷ dhe dëmit jashtëkontraktor⁸. Autori gjerman Karl Larenz, e përkufizon dëmin si një alterim të pafavorshëm të rrethanave që vjen si rezultat i një ngjarjeje specifike

¹ Për më shumë shiko “Definition de la responsabilité civile”, i aksesueshëm në: <https://cours-de-droit.net/definition-de-la-responsabilite-civile-a121605924/>

² Përkufizim i marrë nga Savatier, René; “Traité de la responsabilité civile en droit français civil, administrative, professionnel, procédural”, Revue internationale de droit comparé, 1950.

³ Mamuti, Afet; “Përgjegjësia juridike civile për shpërbimin e dëmit në Maqedoni”, Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2013, fq.65.

⁴ Dauti, Nerxhvane; “E drejta e Detyrimeve, Pjesa e përgjithshme”, Prishtinë, 2016, fq.151.

⁵ Contreras Strauch, Osvaldo; “Civil liability and insurance (An analysis of civil liability and its insurance, under the legal viewpoint of the ‘common law and ‘civil or continental law’systems)”, AIDA International Insurance Law Association, fq.22.

⁶ Morina, Sevdai; “Kriteret dhe kushtet që duhet të plotësohen për caktimin e përgjegjësisë civile për dëmin jashtëkontraktor në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës”, Disertacion për marrjen e gradës shkencore ‘Doktor’, Tiranë 2017, fq.63.

⁷ Dëmi kontraktor është dëmi pasuror që vjen si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve që burojnë nga një kontratë të lidhura me cilësinë, afatin, kohën ose të lidhura me humbjen e interesit për të vazhduar marrëdhënien juridike në të ardhmen apo me dëmin e pësuar, për shkak të pamundësisë së përbushjes së detyrimit përfaj të debitorit.

⁸ Dëmi jashtëkontraktor është dëmi pasuror apo jopasuror që i shkaktohet individit, në kushtet kur nuk ekiston asnjë marrëdhënie juridike e deriatëçastshme mes shkaktuesit të dëmit dhe palës së dëmtuar.

kundër vullnetit të personit dhe që ndikon në të drejtat ligjore që i takojnë atij, qofshin këtu ato të lidhura me personalitetin, integritetin, nderin, pasurinë e tij e jo vetëm⁹.

Sot jetojmë në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, gjithnjë e më të zënë dhe që ndryshon me shpejtësi, në të cilën e drejta civile ka një rol të vazhdueshëm e të rëndësishëm për të siguruar standarde minimale të ndërveprimt midis individëve që kompensojnë dëmshpérblimin e veprimeve të gabuara¹⁰. Në epokën ku jetojmë, sistemet e përgjegjësisë civile po përballen me sfidën e madhe të parandalimit dhe kompensimit të të gjitha dëmeve që na shkaktohen për shkak të jetesës në një shoqëri ku zhvillimi dhe përparimi shkencor dhe teknologjik janë rregull i çdo dite¹¹. Si pasojë, tendencat moderne të ligjit po ndryshojnë aksin e vëmendjes ligjore, duke vendosur në qendër të saj kompensimin e dëmit. Kjo gjë ka bërë që të fitojnë përparësi faktorët objektivë që i atribuohen përgjegjësisë, duke lënë mënjanë aforizmin e vjetër se nuk ka përgjegjësi civile pa faj. Sot ajo çka ka rëndësi vërtet është se nuk ka përgjegjësi civile pa dëm¹².

Evolucioni në fushën e përgjegjësisë civile duket që nga fakti se sot nuk thuhet më se nuk ka përgjegjësi pa faj, por se nuk ka përgjegjësi pa dëme, dhe këto dëme nuk janë vetëm ato që kanë ekskluzivisht karakter individual ose grupor, por dhe ato që ndikojnë në kolektivitetin ose mirëqenien e shoqërisë në tërësi¹³. Kjo përqasje e fundit i ka hapur rrugën një epoke të re, të ashtuquajtur si “drejtësia e dëmeve”, ku qendra kryesore e vëmendjes është viktima e dëmit dhe ku mbi të gjitha interesit më i madh është fokusuar në mbrojtjen e qenies njerëzore, më shumë se sa në kërkimin e personit civilisht përgjegjës¹⁴.

⁹ Larenz, Karl & Canaris, Claus-Wilhelm; “Methodenlehre der Rechtswissenschaft”, Springer-Lehrbuch, New York, 1995.

¹⁰ Witting, Christian & Goh, Yihan; “Evolving personal torts”, Singapore Academy of Law Journal, 2015, fq.607.

¹¹ Taboada, Lizardo; “Los nuevos daños jurídicamente indemnizables y la responsabilidad civil moderna”, 2012, i disponueshëm në: <http://blog.pucp.edu.pe/blog/seminariotallerdpc/2012/10/17/los-nuevos-danos-juridicamente-indemnizables-y-la-responsabilidad-civil-moderna/>

¹² Contreras Strauch, Osvaldo; “Civil liability and insurance (An analysis of civil liability and its insurance, under the legal viewpoint of the ‘common law’ and ‘civil or continental law’ systems)”, AIDA International Insurance Law Association, fq.26.

¹³ Cordóba, Jorge & Sanchez Torres, Julio; “El derecho de daños en el nuevo milenio”, Alveroni Ediciones, Cordoba, Argjentinë 2014, fq.43.

¹⁴ Përshtatur nga Gonzales Agurto, Antonio Carlos; “El nuevo derecho de daños. Daño a la persona y daño al proyecto de vida”, Editorial Temis S.A, Bogota, Kolumbi, 2019, fq.18.

Megjithëse tashmë është gjërësisht i pranuar fakti se koncepti i drejtësisë së dëmeve ka një përmbajtje më të gjërë sesa ai i përgjegjësisë civile¹⁵, ajo që ka revolucionarizuar dhe vazhdon të revolucionarizojë vërtet fushën e përgjegjësisë civile dhe përrnjedhojë ka sjellë inovacionin më të madh në konceptin e përgjegjësisë civile që njohim sot, është ekzistenca, konfigurimi dhe kategorizimi i dëmeve të reja të kompensueshme, që po njojin kompensim gjithnjë e më të madh juridik si nga doktrina, dhe jurisprudanca vendase dhe e huaj¹⁶. Në këtë prizëm, në një kohë kur fusha e dëmshpërblimeve po bëhet më dinamike se kurrë, disa nga temat që dalin si të rëndësishme janë përgjegjësia përrnjemet e shkaktuara ndaj konsumatorëve nga produktet difektoze; dëmet bërthamore; dëmi informatik; dëmi gjenetik, dëmet e pësuara në trazira ose sulme, dëmi mjedisor¹⁷ dhe një sërë dëmesh të inkluadruara si dëme personale për gjithësa të cilat do bëjmë një analizë përbledhëse më poshtë.

Figurat e reja të dëmit modern

Përparimi gjemetric i arritjeve njerëzore që nga revolucioni industrial deri në epokën teknologjike aktuale ka shkaktuar ndryshime strukturore në sistemet e riparimit të dëmeve dhe përgjegjësisë civile¹⁸. Përveç dëmeve ‘tradicionalë’, prej disa vitesh doktrina dhe jurisprudanca kanë elaburuar figura të reja të dëmit të tillë si¹⁹: dëmi indirekt/ dëmi jopasuror i reflektuar, dëmet kolektive;²⁰ dëmet ekologjike; dëmet e shkaktuar konsumatorit; dëmet psikosomatike ose të njoitura ndryshe dëme-event²¹; dëmi mbi projektin e jetës; dëme estetike; dëmet bërthamore; dëmet e shkaktuara nga zhurmat;

¹⁵ Cordobera Garrido, Lidia; “La percepción y configuración de los nuevos daños. Reflexiones sobre su inserción en la enseñanza jurídica”, Academia Revista sobre enseñanza del Derecho, No.9, Argentinë 2007, fq. 55.

¹⁶ Për më shumë shih Taboada, Lizardo; “Los nuevos daños jurídicamente indemnizables y la responsabilidad civil moderna”, 2012.

¹⁷ Shih: Cordóba, Jorge & Sanchez Torres, Julio; “El derecho de daños en el nuevo milenio”, Alveroni Ediciones, Cordoba, Argentinë 2014, fq.36.

¹⁸ Taboada, Lizardo; “Los nuevos daños jurídicamente indemnizables y la responsabilidad civil moderna”, 2012.

¹⁹ Për më shumë shiko: Serrano, Gazquez, Laura; “El daño en el ordenamiento jurídico español: Nuevos daños? Análisis Jurisprudencial”, Congreso Iberoamericano de Derecho Privado, 2017, fq.4.

²⁰ Dëmet kolektive janë një modalitet i ri dëmi dhe konceptohet në veteve si një dëm që prek në të njëjtën kohë, disa të drejta të personalitetit të një grupi njerëzish, për më shumë shiko: Junior, Da Silva, Rodrigues, Enivaldo; “Do dano na responsabilidade civil extracontratual”, 2018.

²¹ Dëmi psikosomatik merr parasysh natyrën komplekse dhe dy dimensionale të qënies njerëzore. Shkaktimi i tij konceptohet i lidhur nga njëra anë me aspektin fizik, funksionet fiziologjike dhe shëndetin mendor të njeriut, e nga ana tjeter prek dhe qënien njerëzore në lirinë dhe dimensionet e veta shpirtërore. Sipas disa autorëve, ky lloj dëmi është bashkim i dëmit biologjik dhe atij ekzistencial.

dëmet informatike e të tjera. Këto lloje/kategori të reja dëmesh të kompensueshme janë pasojë e zhvillimit të doktrinës së përgjegjësisë civile, në varësi të ndryshimeve të shoqërisë moderne, jo vetëm në fushën shkencore dhe teknologjike, por gjithashtu në interesat e reja të individëve të cilat aktualisht konsiderohen se meritojnë mbrojtjen e rendit juridik për shkak të aktiviteteve profesionale, industriale dhe inovatore²².

Dëmi informatik

Dëmi informatik i njojur gjerësishet dhe si sabotazh informatik — *cyberpunking*, vandalizëm informatik, vandalizëm elektronik, *cracking* ose, *hacking*—i referohet, në përgjithësi, gjithë grupit të sjelljeve me natyrë informatike që dëmtojnë ose pengojnë funksionimin e duhur të teknologjive dixhitale, duke përashtuar nga ky koncept, natyrisht, veprimet që përdoren në sistemin pér të futur të dhëna, pér të drejtar sjellje ose pér të shpërndarë informacion²³. Brenda përkufizimit të atij që quhet ‘dëm informatik’ përfshihet si shkatërrimi i sistemeve informatike të plota, ashtu edhe i komponenteve të tyre të veçanta, qofshin ato pajisje, të dhëna, dokumente apo dhe programe²⁴.

Dëmet që lidhen me marrëdhëni kontraktuale pér blerjen e hardware-it dhe software-it, si dhe ato që rrjedhin nga manipulimi i të dhënavë personale të rezervuara, janë të rëndësishme pér shkak të ndikimit të tyre social dhe ekonomik²⁵²⁵. Ndryshe nga veprat e dëmshme që ndodhin në botën materiale, veprat e dëmshme informatike zakonisht përqendrohen tek “*humbjet financiare, dëmtimi i reputacionit ose dëmtimi emocional, më shumë sesa dëmtimi personal ose dëmtimi fizik i pronës.*”²⁶²⁶. Në përgjithësi, veprat e dëmshme në informacion shkaktojnë dëme që janë shumë më të vështira pér

²² Dëmi psikosomatik merr parasysh natyrën komplekse dhe dy dimensionale të qënies njerëzore. Shkaktimi i tij konceptohet i lidhur nga njëra anë me aspektin fizik, funksionet fiziologjike dhe shëndetin mendor të njeriut, e nga ana tjeter prek dhe qënien njerëzore në lirinë dhe dimensionet e veta shpirtërore. Sipas disa autorëve, ky lloj dëmi është bashkim i dëmit biologjik dhe atij ekzistencial.

²³ Taboada, Lizardo; “*Los nuevos daños jurídicamente indemnizables y la responsabilidad civil moderna*”, 2012.

²⁴ Barranco de la Marta Javier, Norberto & Diaz Hernández, Leyre; “*El delito de daños informáticos, una tipificación defectuosa*”, Estudios penales y crimológicos, No.29, 2009, fq. 316.

²⁵ Cordóba, Jorge & Sanchez Torres, Julio; “*El derecho de daños en el nuevo milenio*”, Alveroni Ediciones, Cordoba, Argjentinë 2014, fq.39.

